



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraševac/Municipality Rahovec



Procesverbal i dëgjimit publik buxhetor me drejtorë të shkollave,
koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e buxhetit për vitin 2027, me drejtorë të shkollave, koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët u publikua me datë: 07.5.2026 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz:

<https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/NJOFTIM-PUBLIK-Degjimi-buxhetor-me-drejtor-te-shkollavekoordinatore-te-cilesisepsikolog-dhe-pedagoget.pdf>

në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim nga data: 20.5.2026 deri me datë: 22.5.2026 do të organizohen gjashtë (6) dëgjime publike buxhetore.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për gjashtë (6) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz:

<https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Kalendari-i-degjimeve-per-pergatitjen-e-KAB-2027-2029-1.pdf> më datë: 30.4.2026.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar **drejtorë të shkollave, koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët**, ku janë janë të informuar rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit në ueb faqe të komunës.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me **drejtorë të shkollave, koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët**, u publikua më datë 22.5.2026 në këtë vegëz:

<https://www.facebook.com/share/p/1Fv8JaDJoh/> Njoftimet janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike si dhe në rrjetin social Facebook.

DËGJIMI PUBLIK ME DREJTORË TË SHKOLLAVE, KOORDINATORËT TË CILËSISË, PSIKOLOGËT DHE PEDAGOGËT

Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët, u mbajtë më: **22.5.2026** në Sallë të Kuvendit Komunal, me fillim në ora **10:00**.

Pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 34

- Femra ishin: 12
- Meshkuj ishin: 22

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Të pranishëm: Drejtori i Financave, Afrim Limani, drejtori i DKA – së, Muhamet Morina, zyrtarët e Drejtorisë së Financave dhe anëtarët e grupit punues për buxhet.

Takimin e hapi anëtarja e grupit punues për buxhet **znj. Blerta Gashi**, ku i dëshirojë mirëseardhje të gjithë të pranishmëve. Për më shumë rreth buxhetit të vitit 2027 fjalën e ka drejtori për buxhet dhe financa z. **Afrim Limani**.

Afrim Limani, drejtor për Buxhet dhe Financa: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë! Më 15 maj 2026 ka ardhur qarkorja e parë buxhetore financiare që përcakton kufijtë dhe tavanet buxhetore për buxhetin e Komunës së Rahovecit. Sipas qarkores së parë buxhetore, buxheti i Komunës së Rahovecit në total, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake do të jetë 21,704,248.00€. Nëse bëjmë krahasim me vitin 2026, atëherë është një rritje e buxhetit prej 156,514.00€, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake. Ne e presim edhe qarkoren e dytë buxhetore në muajin korrik, ku kjo qarkore pastaj do të caktojë qartë të gjitha pozicionet buxhetore edhe pse ne mendojmë që nuk do të ketë shumë ndryshime nga qarkorja e parë. Granti i Administratës është 9,946,627.00€, që ka rritje krahasuar me vitin e kaluar për 778,566.00€. Granti i Arsimit është 6,843,506.00€, në krahasim me vitin 2026 ka një zbritje prej 660,795.00€. Granti i Shëndetësisë është 2,323,338.00€, që në krahasim me vitin 2026 ka një zbritje prej 36,883.00€. Në total, buxheti është 21,704,248.00€. Buxheti në kategori ekonomike përafërsisht do të jetë kështu: Pozicioni i pagave do të jetë 12,919,962.00€, në krahasim me vitin 2026 kemi një rritje prej 465,407.00€. Mallra dhe Shërbime janë 2,821,000.00€, ka rritje krahasuar me vitin 2026 për 59,994.00€. Komunalitë janë 440,000.00€, ka rritje krahasuar me vitin 2026 për 50,000.00€. Subvencionet mbesin të njëjta krahasuar me vitin 2026, 1,000,000.00€. Investimet Kapitale janë 4,523,286.00€, dhe ka një zbritje prej 418,887.00€, krahasuar me vitin 2026. Gjithashtu paraqiti edhe dy faktor kryesor që do të ndikojnë

në problemet financiare edhe këtë vit, njëjtë si vitin e kaluar për komunën tonë: Kontrata Kolektive si dhe numri i ulët i popullsisë për komunën e Rahovecit të bërë nga regjistrimi i fundit i përfunduar në vitin 2024, sidomos Kontrata Kolektive, ku vetëm këtë vit nga buxheti për Investime Kapitale, janë marrë 3.5 mil.€, prandaj kemi një zbritje sidomos te pozicioni i Investimeve Kapitale. Ky është në total buxheti i Komunës së Rahovecit, për vitin 2027. Në dorë keni edhe një dokument, që sipas programeve dhe kategorive ekonomike ta dini shpërndarjen e buxhetit.

Emrat	Kërkesat nga drejtorë të shkollave, koordinatorët të cilësisë, psikologët dhe pedagogët
z. Muhamet Morina, drejtor i DKA - së	Pyetje rreth numrit të nxënësve për vitin shkollor 2025/2026 dhe 2024/2025?
znj. Vjollca Vuqitërna, drejtoreshë në SHMLP "Selajdin Mullabazi – Mici"	Pyetje rreth investimeve në shkollë, në dyer dhe dritare?
znj. Beatrisa Pista, drejtoreshë në SHFMU "Bekim Sylka"	Kërkesë që të ketë kujdes rreth obligimeve financiare për ngrohje si dhe mjete higjienike?
z. Halit Sahitaj, drejtor i SHFMU "Rilindja"	Pyetje rreth krijimit të paraleleve në shkolla se si duhet të bëhet?
z. Ilir Kryeziu, drejtor i SHFMU "Haki Stërmilli"	A është bërë analizë rreth situatës së krijuar financiare?

Drejtori i Financave, Afrim Limani, numri i nxënësve në vitin shkollor 2024/2025 ka qenë 7,888, ndërsa në vitin shkollor 2025/2026, është 7,148. Diferenca është 740, nxënës më pak, që ndikon drejtpërdrejt në uljen e grantit specifik për Arsim, uljen e mjeteve për mallra&shërbime dhe komunal, për arsye të zbatimit të formulës në raportin mësimdhënës/nxënës.

Situata e krijuar financiare është e vështirë, prandaj do të shikohet më kujdes shpenzimi i buxhetit dhe do t'ju jepet përparësi atyre kërkesave më prioritare. Do të shohim nëse mundemi të përfshijmë në projektin për efikasitet, ndërrimin e deryve dhe dritareve në SHMLP "Selajdin Mullabazi".

Edhe përkundër krizës financiare, ne jemi kujdesur që mos të ulim mjetet në kategorinë Mallra&Shërbime dhe Komunal, por përkundrazi për vitin 2027, i kemi rritur mjetet për këto dy kategori dhe do të kryejmë obligimet financiare prioritare sidomos ngrohja qendrore dhe mjetet higjienike.

Edhe te planifikimi i klasave duhet të jeni më të kujdesshëm sidomos te krijimi i paraleleve për nxënës, që të jetë sipas udhëzimeve administrative dhe ligjit.

Vazhdimisht së bashku me ekipin tim të financave analizojmë me kujdes këtë situatë të krijuar financiare, ku e cekim me herët që kontrata kolektive është barrë për neve, dhe kjo ka qenë faktori kryesor që jemi në këtë

gjendje. Por besoj që vitin tjetër të jemi më mirë në aspektin financiar, dhe së bashku të punojmë që të reduktojmë kostot e panevojshme.

z. **Muhamet Morina, drejtor i DKA** – së, pas marrjes së detyrës si drejtor jam kujdesur që ti vizitoj pothuajse të gjitha shkollat për tu njohur më afër me sfidat dhe kërkesat e tyre, e di që ka vështirësi por kërkoj nga të gjithë ju që bashkërisht të punojmë që këto sfida ti përballojmë më lehtësi dhe të dalim nga kjo situatë e krijuar financiare.

Ju faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në takimet e radhës!







Procesmbajtësi:

Egzon Fraqi
Egzon Fraqi



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Komuna e Rahoveci
 Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë, psikologët dhe pedagogët

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1.	Selajdin	Devdalla	Rahovec		
2.	Themsiye	Shala	Rahovec		
3.	Gjofica	Vugitama	Rahovec		
4.	Bratona	Çan	Rahovec		
5.	Simon	Bojduku	Rahovec		
6.	Shani	Haxhi	Rahovec		
7.	Elmi	Krasniqi	Rahovec		
8.	Yzet	Yzet	Rahovec		
9.	HR	KRJEVI	Rahovec		
10.	Spencer	Lironi	Rahovec		
11.	Asim	Bitkici	Rahovec		
12.	Elhami	Shumica	Rahovec		
13.	Asim	Solaki	Rahovec		
14.	Xherdet	Monica	Rahovec		
15.	Valbona	Hati	Rahovec		
16.	Haret	Vahiti	Rahovec		
17.	Xherdet	Hati	Rahovec		
18.	Bedri	Dilori	Rahovec		
19.	Bojduku	Rufa-Dema	Rahovec		
20.	Themsiye	Çan	Rahovec		

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës,unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana tme për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Komuna e Rahovecit
 Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësive, psikologët dhe pedagogët

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1.	Elife	Haxhimi-Hoti	K. e Madhe		Alpen
2.	Mahmud	Durali	K. e Madhe		Enas
3.	Hysni	Sylla	Rahovec		H.
4.	Fatime	Xoronica	Rahovec		X.
5.	Blerina	Thaçi	Xërxi		B.
6.	BAJRAM	MORINA	BRATOTIN		Bajram
7.	Lamir	Braçinca	Kiamanki		L.
8.	NERI	SYLEJMANI	P. POSHTEM		N.
9.	Nurda	Dula	Rahovec		N.
10.	Kacim	Kraçevica	Rahovec		K.
11.	Dorjeta	Ugaj-Hinaj	Krashe e Madhe		D.
12.	Piccart	Vendi	Krashe e Madhe		P.
13.	Shender	Çarshi	H. e Vogël		S.
14.	Vahdet	Kollari	Rahovec		V.
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se kam qenë i pranishëm në të paktën një kontakt të afërt nga ana ime për të marrë pjesë në dëgjimet publike për buxhetin për vitin 2026. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.